

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sportit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, zhvilloi një aktivitet sportiv me studentë të degëve të ndryshme.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i një stili jetese të shëndetshme dhe inkurajimi i të rinjve për t'u përfshirë në aktivitete sportive dhe sociale.

Studentët, nën udhëheqjen e pedagoges Msc. Elvira Barka, zhvilluan një sërë ushtrimesh fizike dhe joga, të cilat synuan përmirësimin e gjendjes fizike, reduktimin e stresit, si dhe nxitjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndërmjet studentëve.

